



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:045972
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05498939

A.C.nr.8549/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Fatmir Baloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.A., nga fshati ..., Komuna Novobërdës, të cilën e përfaqëson me autorizim R.G, nga Zyra për Shërbime Juridike dhe Ndërmjetësim, Komuna Gjilan, kundër të paditurës Komuna Novobërdë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.36/22 datë 28.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna Novobërdë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.36/22 datë 28.10.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.36/22 datë 28.10.2022, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. MIRATOHET plotësisht e bazuar padija e paditëses V.A., nga fshati ... dhe e paditura Komuna e Novobërdës Drejtoria e Arsimit DETYROHET që paditësit t'ia paguajë paditësit shumë prej 1010.00 euro me kamatë ligjore deri më 30 shtator, 2022 në shumë totale 1064,40 euro, me kamatë të ligjshme nga 1 tetor 2022 deri në pagesën përfundimtare, të gjitha brenda 7 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit. II. MIRATOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesë për rimbursim të shpenzimeve të procedurës në pjesën që ka të bëjë me pagesën e tarifës gjyqësore në vlerë prej 31 euro, pagesën e shpenzimeve për ekspertizë në vlerë prej 150 euro. , pra i padituri merr përsipër t'ia paguajë paditësit shumë prej 181 euro në emër të shpenzimeve të procedurës në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit. III. REFUZOHET si pjesë e pabazuar e padisë, e cila ka të bëjë me pagesën e shpenzimeve për përgatitjen e padisë në shumë 100 euro, plotësimin e padisë në vlerë prej 50 euro dhe pjesëmarrjen në dy seanca nga 120 euro secila në shumën totale prej 390 euro...”

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës material, me propozim Gjykatës së Apelit që të aprovohet ankesa si a bazuar dhe të kthehet lënda në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësja me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja V.A., nga Komuna Novobërdë, me datë 09.03.2022, ka ushtruar padi për kompensimin e shujtës, kundër të paditurës Komuna Novobërdë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë.

Gjykata e shkallës së parë me datë 28.10.2022, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.36/22 datë 28.10.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka theksuar se: *“...Dispozitat e nenit 35 paragrafi 7 i Marrëveshjes Kolektive për Arsimin Parauniversitar datë 18 prill 2017, si marrëveshje sektoriale që rregullon marrëdhëniet ndërmjet palëve kontraktuese për sektorin e arsimit parauniversitar, parashikon se “Punonjësit kanë të drejtë në kompensim për ushqim gjatë punës për ditët e kaluara në punë. Tarifa për një vakt të ngrohtë për një ditë pune është 2 (dy) euro. Punëdhënësi*

që u siguronte punëmarrësve ushqimin nëpërmjet kuzhinës ose në ndonjë mënyrë tjetër, nuk ka asnjë detyrim t'ua rimburojë punonjësve shpenzimet për ushqim...”.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë nuk është kontestuese se paditësi është punëtorë te e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë, dhe nuk është kontestuese se paditësi gjatë periudhës kontestuese te e paditura ka gjithsejtë 723 ditë pune.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që në emër të shujtave ditore për 505 ditë, t'ia paguaj shumën prej 1.010.00 Euro, Gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitën e nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: *“...Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...”*, e cila Kontratë është lidhur dhe është nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, si dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës, dhe Kulturës e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, dhe e datës 22.01.2021, ndërsa paditësja deri në momentin e plotësimit të kushtit i ka arritur ditët për shujtat e cekura më lartë, dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia është e bazuar.

Në raport me pretendimin ankimor të paditurës se kontrata kolektive në të cilën është thirrur paditësja dhe gjykata dhe konsiderimit se kjo kontratë është në kundërshtim me Ligjin e punës dhe se Komuna e Novobërdës, si punëdhënëse e paditëses nuk është nënshkruese e kësaj Kontrate Kolektive, Gjykata e Apelit e refuzon si të pa themeltë një pretendim të tillë për shkak se me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: *“...Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet...”*, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Janë vlerësuar pretendimet ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Numri i lëndës: 2022:045972
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05498939

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8549/2022 datë 25.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi